

**" FARMATURK" SHPK**  
**" (Shoqeri ne Likuidim)**

**NIPT: L71906028R Tirane**

**Raport mbi mbylljen e procedurave te Likuidimit te shoqerise**  
**FARMATURK- Shpk**

**1. Prezantim**

FARMATURK– Shpk, eshte themeluar si Shpk me 06.07.20217 ne QKR me dy Ortake, Znj. Arjana Sina dhe shtetasin turk Ahmet Kal.

Aktiviteti i tyre ka qene Farmaci. Ne Objektin e aktivitetit ka te shenuar dhe veprimtari si: Ushtrimin e veprimtarise farmaceutike dhe administrimin e saj nepermjet shitjes se artikujve farmaceutik te lejuar nga ligji sic jane; specialitetet e ilaceve, produkte gjenetike, parafarmaceutike, barna me lende organike, produktet dietike, kozmetike te higjenes vetjake, produkte per femije dhe ato sanitare, lojrat edukuese, produkte okulistike, syze, aparate degjimi, pajisje ortopedike, produkte ushqimore, monoperdorues e protezat. Kjo shoqeri mund te marre koncesione te shitjes dhe ekskluzivitet per produktet e lartpermendura qofshin produkte importi apo eksporti. Ndermjetesim kontrata biznesi, komisioner ne shitje, konsulence biznesi, tregti import eksport, koncensione te ndryshme.

Shoqeria ka ushtruar veprimtari tregtare prane spitalit ITH qe ndodhet prane. Drejtimi duke pare nivelin e ulet te xhiros dhe te marzhit te fitimit, kane arritur ne konkluzionin qe veprimtaria tregtare nuk eshte me e leverdisshme per ortaket e shoqerise. Keshtu qe shoqeria me date 01.09.2021 merr vendimin duke kerkuar mbylljen e shoqerise.

Eshte percaktuar dhe Likuidatori Ahmet Gjinishi, shqiptar, me nr ID 035172211, banues ne Tirane.



Shoqeria, ka patur Kapitalin te sajn ne vleren 100.000 leke.

Asambleja e Ortakeve te shoqerise FARMATURK– Shpk mbeshtetur ne nenet 187-190 te ligjit nr 9901 date 14 Prill 2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" merr vendim nr 01 date 01.09.2021 per miratimin e prishjes se shoqerise dhe hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese.

**2. Zbatim i Procedurave te Likuidimit**

Bazuar ne vendimin e Asamblese se Pergjithshme te shoqerise FARMATURK– Shpk date 01.09.2021, per prishjen e shoqerise dhe hapjen e procedurave te likuidimit, nga ana e shoqerise u kryen keto procedura:

1. Ne mbeshtetje te nenit 49 te ligjit nr. 9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te regjistrimit" shoqeria FARMATURK (shoqeri ne likuidim) depoziton aplikimin per fillimin e procedurave te likuidimit prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.
2. Ne mbeshtetje te nenit 195 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" shoqeria FARMATURK (shoqeri ne likuidim) fton kreditorët e shoqerise te



**“ FARMATURK ” Shpk**  
*Rruga Donika Kastrioti, Tirane*  
*NIPT L71906028R*

---

- depozitojne pretendimet e tyre lidhur me prishjen e kesaj shoqerie (njoftimi i pare). Njoftimi u publikua me nr 12277 date 16.09.2021 nepermjet faqes se internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit.
3. Ne mbeshetje te nenit 195 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" shoqeria " FARMATURK" (shoqeri ne likuidim) fton kreditorët e shoqerise te depozitojne pretendimet e tyre lidhur me prishjen e kesaj shoqerie (njoftimi i dyte). Njoftimi u publikua me nr 416051 date 18.10.2021 nepermjet faqes se internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit.
  4. Ne mbeshetje te nenit 198 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" shoqeria " FARMATURK" (shoqeri ne likuidim) pergatit "bilancin per gjendjen ne hapje te procedurave te likuidimit dhe qe i referohet gjendjes me 01.09.2021.
  5. Shoqeria vazhdon procedurat lidhur me permbushjen e detyrimeve ndaj paleve te treta dhe ne mbeshetje te nenit 198 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" shoqeria FARMATURK (shoqeri ne likuidim) pergatiti bilancin perfundimtar ne mbyllje te procedurave te likuidimit dhe qe i referohet gjendjes me 30.11.2021.
  6. Shoqeria FARMATURK, mbledh Asamblene e Pergjithshme te Ortakut te Vetem Nr. 02 date 30.11.2021 dhe miraton pasqyrat financiare te shoqerise per gjendjen me 30.11.2021 si dhe Raportin e Likuidatorit, sipas dokumentacionit te paraqitur nga likuidatori;

**POZICIONI FINANCIAR I SHOQERISE**

Pozicioni financiar i shoqerise " FARMATURK" (shoqeri ne likuidim) per gjendjen ne celje te procedurave te likuidimit (referuar dates 01.09.2021), paraqitet si me poshte:

a. Bilanci .

i. Totali aktiveve me	ALL	1.696.106
Totali i detyrimeve me	ALL	18.553
iii. Kapitali me	ALL	1.677.553

b. Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve:

i. Totali te ardhurave me	ALL	4.456.291
ii. Totali i shpenzimeve me	ALL	4.420.204
iii. Fitimi/(Humbja) para tatimit	ALL	36.087

Gjate periudhes qe shoqeria ishte ne likuidim jane kryer veprimet si me poshte:

1. Jane permbushur te gjitha detyrimet ndaj paleve te treta, autoriteteve te taksave si dhe furnitoreve;
2. Nuk kane rezultuar detyrime ose pretendime nga pale te treta per te cilat shoqeria nuk ka patur dijeni ose qe te kene qene jashte mardhenieve kontraktore;
3. Nuk ka patur arketime per detyrime qe palet e treta i kane patur ose te drejta qe kane lindur gjate procesit te likuidimit;
4. Nuk jane kryer kompesime te drejta dhe detyrimeve me palet e treta.
5. Shoqeria dispononte ne inventarin e saj 1.368.087 leke mallra per rishitje te cilat perbeheshin nga medikamente dhe profilaktik, te cilat per nje kohe te gjate nuk ishin shitur



**“ FARMATURK ” Shpk**  
*Rruga Donika Kastrioti, Tirane*  
*NIPT L71906028R*

---

dhe me nje kohe te shkurter te afatit te perdorimit. Drejtimi nuk arriti dot ti shese perpara celjes se likujdimit por edhe me asistencen e likujdatorit nuk u arriten konkluzione te pranueshme nga palet. Per kete arsye Likujdatori ne pasqyrat financiare te mbylljes se likujdimit paraqet si fitim i munguar vleren e mallit duke aplikuar marzhin e fitimit te se njejtës periudhe, e gjitha kjo per efekt te tatim fitimit.

6. Shoqeria ka patur asete te ne gjendje me vlere 16.329 leke te cilat ishin mobileri rafte e banak. Kjo vlere paraqitet ne pasqyrat financiare permbyllese, por per efekt te tatim fitimit do te llogaritet si shpenzim i panjohur.

Perfundimisht, pozicioni financiar i shoqerise " FARMATURK" (shoqeri ne likuidim) per gjendjen ne mbyllje te procedurave te likuidimit (referuar dates 30.11.2021), paraqitet si me poshte:

C. Bilanci :

i. Totali aktiveve	ALL	0,00;
ii. Totali i detyrimeve	ALL	0,00;
iii. Aktivët neto	ALL	0,00;

Detyrimet me date 30.11.2021 jane ne gjendjen zero.

Keto detyrime jane shlyer perpara dates se paraqitjes se ketij raporti.

Fitimet e mbartura jane vleren 1.577.553 leke, te cilat i shpendahen ortakeve duke i mbajtur

Tatimin mbi Fitim sipas dispozitave ne fuqi.

Kapitalin e tyre te neshkruar prej 100.000 leke iu kthehet i plote.

d. Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve:

i. Totali te ardhurave-Ndryshimi i Inventareve	ALL	1.554.896;
ii. Totali i shpenzimeve	ALL	1.384.416;
iii. Fitimi/ (Humbja) para tatimit (Efekt Tatimi)	ALL	170.480;


Deklarimi i Pasqyrave do te behet te sistemin c@ts ku dhe do te paguhen rezultatet perkatese. Kompania ne celjen e likujdimit rezulton 1.577.553 leke fitime. Rezultojne dividente per te shpendare dhe Tatim ne burim per te perlllogaritur.

Gjendja likuiditeteve ne arke ne daten e mbylljes se procedurave te likuidimit eshte 0,00 lek

Pjese perberse e ketij raporti jane pasqyrat financiare te pergatitura per shoqerine FARMATURK (shoqeri ne likuidim), per gjendjen ne mbyllje te procedurave te likuidimit (referuar dates 30.11.2021) si dhe vendimi i Asamblese Pergjithshme te Ortakut per miratimin e ketyre pasqyrave dhe Raportit te Likujdimit.

LIKUIDATOR

**Ahmet Gjinishi**



Date 30.11.2021